



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E  
BURGJEVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA  
DISKRIMINIMI



Nr. 1571/2 Prot, datë 31.12.2012

Nr. 519 Prot, datë 20.12.2012

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

dhe

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) (të quajtura në vijim "Palë")

*Duke vlerësuar rëndësinë e promovimit, garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit;*

*Duke u angazhuar për marrjen përsipër për sigurimin e të gjitha mjeteve të nevojshme për mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve;*

*Duke konsideruar* si domosdoshmëri ushtrimin e ndërsjelltë të veprimtarisë institucionale me qëllim realizimin e interesave të ligjshme të personave të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve mbështetur në parimin e barazisë përpara ligjit dhe barazisë së shanseve e mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë, si dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve pa diskriminim;

*Duke afirmuar* vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumi;

*Duke u mbështetur* në kuadrin e plotë ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative: në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar;

*Kanë rënë dakord* të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim “Memorandumi”).

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është, bashkërendimi i ndërsjelltë dhe reciprok i veprimtarisë institucionale të punës midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me qëllim ndjekjen, kujdesjen dhe garantimin e një mbrojtje efektive nga diskriminimi apo çdo formë sjellje që nxit diskriminimin të personave të dënuar apo që janë të paraburgosur, në funksion të respektimit dhe zbatimit të Kushtetutës, ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe legjislationit në fuqi.

## **Neni 2**

### **Format e bashkëpunimit**

Bashkëpunimi i ndërsjelltë realizohet nëpërmjet formave:

